OBP
OPERATORI
I BLERJEVE
TË PËRQENDRUARA

BULETINI MUJOR

I VEPRIMTARISË DHE REZULTATEVE TË OPERATORIT TË BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

*korrik*2026

Prokurojmë për Shqipërinë Evropiane!

www.obp.al

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

77	59	96	3,641,468,758 *Lekë*
Kërkesa për prokurim të procesuara	Autoritete përfituese	Procedura të shpallura	Fonde të prokuruara

PROCEDURAT KRYESORE/ME NDIKIM TË MUAJIT

Rikonstruksion i godinës qendrore *Spitali Mat*

Fondi limit
339,857,171.66 Lekë

AK përfituese
Spitali Mat
Ministria e Shëndetësisë

Fondi limit
1,582,500.00 Lekë

AK përfituese
AZHT

Blerje dronësh për *AZHT*



Rikonstruksioni iurgjencës për *Spitalin Rajonal Durrës*

Fondi limit
227,556,574.87 Lekë

AK përfituese
Spitali Rajonal Durrës

Blerje aparatura mjekësore për nevoja të *Spitalit Rajonal Durrës*

Fondi limit

37,495,302 Lekë

AK përfituese

Spitali Rajonal Durrës
Ministria e Shëndetësise

Ngritja e Qendrës me Sistemet Multipikative të Identifikimit Biometrik të personit (AMAIS)
Qendra e Furnizimit Materialo-Teknik, Mullet

Fondi limit

223,600,000.00 Lekë

AK përfituese

Policia e Shtetit

Ndërtimi i Godinës së spitalit për personat me mjekim të detyruar me vendim gykate në *IEVP Shënkoll, Lezhë*

Fondi limit

1,070,358,762.72 Lekë

AK përfituese

Drejtoria e Burgjeve

Mbrojtje bregu nga gërryerjet e lumit *Drin*, *Bahçallek*, *Bashkia Shkodër*

Fondi limit

242,833,854.92 Lekë

AK përfituese

Bordi i Kullimit Lezhë

Blerje okisigjen, ndarë në lote

Fondi limit

234,690,018.58 Lekë

AK përfituese

Spitalet Rajonale

KATEGORITË E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

**Pamja e mëposhtme përmbledh ndarjen e procedurave sipas kodit CPV.*

Statusi	Punë	Mall	Shërbim
Të publikuara	8	58	30

8 Ndërtim

16 Mirëmbajtje

3 Studim

11 Shërbime të tjera

3 Automjete

8 Oksigjen

5 Mobilje dhe orendi

11 Kite dhe reagentë

9 Pajisje mjekësore

3 Kompjuter dhe IT

24 Mallra të tjerë

Procedurat me lote

Treguesi	Rezultati
Procedura me lote	17

Marrëveshjet kuadër

Treguesi	Rezultati
Marrëveshje kuadër	9

PERFORMANCA DHE NDIKIMI

KONKURRENCA DHE PJESËMARRJA

Treguesi	Numri i Procedurave të vlerësuara	Operatorë ekonomikë pjesëmarrës
Rezultati	188	163

ANKESAT DHE ANULIMET

	Numri	DST	Vlerësimi	Pranim i pjesshëm	Refuzim	Në proces shqyrtimi në KPP
Procedura me ankesa	**20** ankesa për **17** procedura unike	**5**	13 **+ 2** për ankimim vendimi **KSHA**	**2**	**4**	**4**
Treguesi						

PROCEDURA TË ANULUARA

5

VEPRIMTARIA INSTITUCIONALE DHE PRIORITETET

REKOMANDIME PËR AUTORITETET KONTRAKTORE DHE OPERATORËT EKONOMIKË

Aspekte për përmirësim në bashkëpunimin me autoritetet kontraktore

Paraqitja me vonesë e kërkesave për prokurim.
Në disa raste, kërkesat dhe dokumentacioni shoqërues paraqiten pranë OBP-së jashtë afateve të përcaktuara. Kjo vështirëson planifikimin, koordinimin ndërinstitucional dhe zhvillimin në kohë të procedurave.

Paraqitja e dokumentacionit të paplotë ose jo në formën e kërkuar.
Në disa raste mungojnë urdhra, procesverbale, argumentime teknike, preventivë, grafikë lëvrimi ose dokumente të tjera të nevojshme. Kjo sjell kthimin e kërkesës për plotësim dhe vonesa në fillimin e procedurës.

Mosarsyetimi i specifikimeve teknike sipas nenit 36 të LPP.
Përcaktimi i të dhënave teknike pa lejuar një diapazon më të gjerë për përmasat e përcaktuara dhe pa parashikuar ekuivalencën për llojin e materialit apo modelin specifik, në mospërputhje me metodat e parashikuara nga neni 36 i LPP-së, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Aspekte për përmirësim nga operatorët ekonomikë

1. *Në zbatim të nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 26 të Rregullave të Prokurimit Publik, operatorët ekonomikë kanë mundësinë të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në vend të disa dokumenteve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta.*

Kur informacioni i deklaruar në formularin e vetëdeklarimit mund të verifikohet nëpërmjet një baze shtetërore të dhënash, operatorët ekonomikë duhet të pasqyrojnë adresën përkatëse elektronike të kësaj baze dhe informacionin e nevojshëm për aksesimin e saj. Nga praktika e vlerësimit të ofertave është konstatuar se, në disa raste, formularët e vetëdeklarimit nuk plotësohen në mënyrën e duhur, duke mos përfshirë adresën përkatëse të bazës së të dhënave ku mund të kryhet verifikimi i informacionit.

2. *Gjithashtu, në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të Rregullave të Prokurimit Publik, operatori ekonomik i renditur i pari duhet të paraqesë dokumentet provuese në origjinal ose të njësuara me origjinalin, të cilat duhet të vërtetojnë gjendjen faktike të tij në momentin e paraqitjes së ofertës. Është konstatuar se, në disa raste, dokumentet e paraqitura mbajnë data të mëvonshme se afati përfundimtar i dorëzimit të ofertave dhe nuk provojnë gjendjen faktike të operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

3. *Një tjetër problematikë e evidentuar lidhet me argumentimin e ofertave anomalisht të ulëta. Në përputhje me nenin 93 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", operatorët ekonomikë duhet të paraqesin argumentim të plotë dhe të detajuar mbi çmimin e ofertuar, duke evidentuar elementët përbërës të kostos, si kostoja e mallrave/shërbimeve/punimeve, shpenzimet e punës, transportit, doganës dhe çdo element tjetër që ndikon në formimin e çmimit.*

Praktika Gjyqësore në Prokurimin Publik

Çështja C-94/12 Swm Costruzioni 2 dhe Mannocchi Luigino

Swm Costruzioni 2 SpA, Mannocchi Luigino DI kundër Provincia di Fermo Vendim gjyqësor i datës 10 tetor 2013, Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm i datës 28 shkurt 2013.

Kërkesë për një vendim paraprak.
Kjo çështje u nis nga një vendim i autoritetit kontraktues për të përjashtuar një konsorcium nga marrja pjesë në tender për një kontratë punësh për modernizimin dhe zgjerimin e një rruge. Procedura u krye në bazë të Direktivës.
Konsorciumi ishte përjashtuar në bazë të një ligji italian i cili kufizonte shkallën në të cilën një operator ekonomik mund të mbështetej në subjektet e tjera për të treguar se ai i plotësonte kërkesat e kualifikimit. Në rastin e kontratave të punëve, një operatorekonomik mund të mbështetej në burimet e vetëm një subjekti tjetër. Vetëm në raste të jashtëzakonshme operatorit ekonomik i lejohej të mbështetej në burimet e më shumë se një subjekti tjetër.
GjD-ja vlerësoi se Direktiva duhej të interpretohej se e ndalonte një kufizim të tillë. GjD-ja iu referua formulimit të neneve 47 (2) dhe 48 (3), të cilat deklaronin shprehimisht se operatorët ekonomikë mund të mbështeteshin tek kapacitetet e "subjekteve" tëtjera - në shumës (paragrafët 30-31). GjD-ja 95 arriti në përfundimin se Direktiva e lejonte operatorin ekonomik që të mbështetej në kombinimin e kapaciteteve të më shumë se një subjekti tjetër për qëllimet e plotësimit të kërkesave minimale. Ky opsion lejohetme kusht që operatori ekonomik të mund të provojë se ai në fakt do t'i ketë ato burime në dispozicion për realizimin e kontratës (paragrafi 33).
GjD-ja pranoi mundësinë e rasteve specifike ku kapacitetet e kombinuara të një numri operatorësh ekonomikë mund të mos ishin të përshtatshme. Kjo papërshtatshmëri do të lindte në kontekstin e kërkesave të veçanta të kontratës. Megjithatë, raste të tilla përbëninnjë përjashtim dhe kufizim që nuk duhej të përcaktoheshin si një rregull i përgjithshëm (paragrafët 35 dhe 36).

www.prokurimet.obp.al

Platforma e re online për dërgimin e kërkesave për prokurim.

Gjatë muajit korrik, Operatori i Blerjeve të Përqendruara vijoi procesin e digjitalizimit të shërbimeve, përmes vënies në funksion të platformës së re **www.prokurimet.obp.al**, e dedikuar për administrimin dhe dërgimin online të kërkesave për prokurim nga institucionet shtetërore.

Në kuadër të përgatitjeve për përdorimin e platformës, u krijuan llogari institucionale për **249 institucione shtetërore**, duke mundësuar aksesin e tyre në një sistem të unifikuar për paraqitjen, administrimin dhe ndjekjen e kërkesave për prokurim.

Platforma synon të **thjeshtojë dhe standardizojë komunikimin ndërmjet institucioneve dhe OBP-së**, të reduktojë procedurat administrative dhe kohën e përpunimit të dokumentacionit, si dhe të rrisë gjurmueshmërinë, transparencën dhe efikasitetin gjatë gjithë procesit.

Ky zhvillim përbën një tjetër hap konkret drejt **modernizimit dhe digjitalizimit të proceseve të prokurimit të përqendruar**, duke krijuar një komunikim më të shpejtë, të sigurt dhe efikas me institucionet publike.

info@obp.al

Rruga “Reshit Çollaku”,
Godina Nr.6/337, Tiranë

www.obp.al